




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.503/2022
Datë: 27 dhjetor 2022

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 dhe 16 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 10 të Rregullores Nr. 12/2022 për Procedurën e Zgjedhjes, Emërimit, Pezullimit dhe Shkarkimit të Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës, në mbledhjen 301-të, të mbajtur me datë 27 dhjetor 2022, merr këtë:

V E N D I M

- I. Themelohet Komisioni Vlerësues i cili do të bëjë intervistimin, vlerësimin si dhe rekomandimin e kandidatëve për kryetar të Gjykatës Supreme të Kosovës, në këtë përbërje:
 1. Qerim Ademaj, zëvendës kryesues i KGJK-së;
 2. Vilard Bytyqi, anëtar i KGJK-së;
 3. Arjeta Sadiku, anëtar i KGJK-së;
 4. Fahret Vellija, anëtar i KGJK-së/anëtar rezervë.
- II. Vendimi hyn në fuqi me datë 27 dhjetor 2022.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës me vendimin KGJK.nr.502/2022, të datës 27 dhjetor 2022, ka shpallur konkurs për pozitën kryetar në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Me qëllim të ndërmarrjes së veprimeve të mëtutjeshme për këtë proces, Këshilli, konform Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshilli Gjyqësor të Kosovës si dhe Rregullores Nr. 12/2022 për Procedurën e Zgjedhjes, Emërimit, Pezullimit dhe Shkarkimit të Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit
- Sekretariatit të KGJK-së, si dhe
- Arkivit.



Albert ZOGAJ,
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës